



Datë: 19.05.2025
Numër Protokolli: 3264/2025

A.nr.449/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.449/2025 të datës 11.03.2025 të parashtruar nga ankuesi B.A, kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.449/2025 e datës 11.03.2025 e parashtruar nga ankuesi B.A.

II. Anulohet Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 28.02.2025, i bërë nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024.

III. Obligohet ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e caktuar sipas Vendimit me Nr.Ref.01/74 të datës 04.11.2024 të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, duke bërë rishqyrtimin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për periudhën si në pikën II të dispozitivit.

IV. Detyrohet ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e caktuar sipas Vendimit me Nr.Ref.01/27 të datës 03.05.2024, që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën nga data 03.05.2024 deri më datë 04.11.2024, si dhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e caktuar sipas Vendimit me Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023 të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin

nga data 01.01.2024 deri më datë 03.05.2024, dhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Obligohet ushtruesja aktuale e detyrës së Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimit si për pikën **III** dhe **IV**.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.A (në tekstin e mëtejme referuar ankuesi) më datë 11.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa Këshilli më datë 03.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 23.04.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1592/2025 të datës 11.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftim i B.Xh.; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i B.Xh. i datës 20.01.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil i B.Xh. i datës 28.02.2025; E-mail nga simbnj për B.Xh. i datës 28.02.2025; E-mail nga B.Xh. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 11.03.2025; E-mail nga ankesa.kpmschck@rks-gov.net për B.Xh. i datës 11.03.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 28.03.2025; Përgjigje në ankesë i datës 03.04.2025; E-mail nga A.B. për N.Sh. etj. i datës 28.03.2025; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 20.01.2017; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i Q.A. i datës 09.02.2015; Vendim me numër Ref.Nr.01/74 i datës 04.11.2024 për caktimin nëpunëses Q.A. ushtruese e detyrës së Sekretares së Përgjithshme në MINT; Planifikimi përfundimtar i prokurimit për vitin fiskal 2024 i datës 12.01.2024 ¼ faqe; E-mail nga E.A. për V.R.V. i datës 02.04.2025; E-mail nga E.A. për V.R.V. i datës 02.04.2025; E-mail nga V.R.V. për E.A. i datës 02.04.2025; E-mail nga E.A. për V.R.V. i datës 02.04.2025; E-mail nga V.R.V. për E.A. i datës 02.04.2025; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës

04.11.2024-08.11.2024; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 11.11.2024-15.11.2024; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 18.11.2024-22.11.2024; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 25.11.2024-29.11.2024; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 02.12.2024-06.12.2024; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 09.12.2024-13.12.2024; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 16.12.2024-20.12.2024; Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 23.12.2024-27.12.2024; E-mail nga Q.A. për A.B. i datës 02.04.2025; E-mail nga A.B. për Q.A. i datës 02.04.2025; E-mail nga A.B. për N.Sh. etj. i datës 01.04.2025; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 2699/2025 i datës 23.04.2025; Vendim me numër Ref.Nr.01/33 i datës 19.05.2023 për caktimin e nëpunësit D.L si zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT; Vendim me numër Nr.Ref.01/27 i datës 03.05.2024 për caktimin e nëpunëses civile S.B-I ushtruese e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të MINT;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit Emërimit të datës 20.01.2017 ankuesi mbanë pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 28.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024 dhe atë në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit ka nevojë për përmirësim.

Ankuesi në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025 nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024 pretendon se vlerësimi fillimisht nuk është nënshkruar as nga vlerësuesi as nga i vlerësuar, pa kurrfarë argumenti ka bërë vlerësimin e punës, për periudhën e vlerësimit asnjëherë u.d. sekretarja nuk ka paraqitur ndonjë vërejtje për mosrealizimin e punëve, po ashtu nuk kam pasur asnjë kërkesë apo ndonjë detyrë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të cilën nuk e kam kryer dhe po ashtu nuk është bërë vlerësimi për periudhën një vjeçare siç parashihet me Rregulloren (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë përkatësisht nenin 10 në rastet e ndërrimit të mbikëqyrësit, kërkon ti aprovohet ankesa si e bazuar.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike administrative ju referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik i aplikueshëm nga data 26.09.2023, respektivisht:

-Nenit 52, paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, ku përcaktohet: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara,*

vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunës/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përfundimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme.

Kolegji i Këshillit, po ashtu ju referua edhe Rregullores (QRK) Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë (e cila ka qenë në fuqi deri më datë 04.10.2024) dhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë (e cila është e aplikueshme nga data 04.10.2024), të cilët përcaktojnë vlerësimin e rezultateve në punë, vlerësimin e realizimit të detyrave të punës, vlerësimin e aftësive profesionale, vlerësimin e aftësive metodologjike, personale dhe sociale, nivelet e vlerësimeve, periudhën e vlerësimit.

Në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024, vlerëson se nga shkresat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë janë dërguar Planifikimi përfundimtar i prokurimit për vitin fiskal 2024 i datës 12.01.2024, Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 03.01.2024-05.01.2024, Raport javor i punës i

Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 11.11.2024-15.11.2024, Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 18.11.2024-22.11.2024, Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 25.11.2024-29.11.2024, Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 02.12.2024-06.12.2024, Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 09.12.2024-13.12.2024, Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 16.12.2024-20.12.2024, Raport javor i punës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit i datës 23.12.2024-27.12.2024.

Tutje nga analizimi i provave të lëndës, kuptohet fakti se Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk ka arritur me prova bindëse të argumentoj faktin se nga pesë (5) objektivat e përcaktuar në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë ku për objektivin e parë lidhur me nivelin e vlerësimit është vlerësuar me *arrinë pritshmërinë*, për objektivin e dytë është vlerësuar sipas nivelit *e papranueshme*, për objektivin e tretë është vlerësuar sipas nivelit *arrin pritshmërinë* për objektivin e katërt është vlerësuar sipas nivelit *ka nevojë për përmirësim* dhe për objektivin e pestë është vlerësuar sipas nivelit *ka nevojë për përmirësim*, ndërsa në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Këshillit, konstaton se Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me rastin e dërgimit të përgjigjes në ankesë nuk ka argumentuar me asnjë provë të vetme lidhur me pretendimet e vlerësuesit ngase nuk ka sjell prova materiale me të cilat e argumenton që ankuesi nuk ka arritur përmbushjen e detyrave të punës. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, nuk është argumentuar me asnjë provë konkrete se vlerësimi është bërë real dhe në pajtim me gjendjen e fakteve, andaj si rezultat i kësaj, duke marr parasysh Raportet javore të punës së ankuesit për periudhën janar-dhjetor 2024 të Divizionit të Prokurimit konstaton se ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e caktuar sipas Vendimit me Nr.Ref.01/74 të datës 04.11.2024 është e obliguar të ndërmarr veprimet me qëllim të rishqyrtimit të vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për periudhën si në pikën II të dispozitivit dhe rivlerësimin duhet t'a bëjë mbi bazë të fakteve dhe provave konkrete dhe po ashtu të respektoj në përpikëri dispozitat ligjore.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në parimin e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, e ku nëpunësi civil duhet të vlerësohet për punën e tij për vitin kalendarik, në bazë të provave materiale të çështjes, ankuesi nuk është vlerësuar për tërë vitin 2024, ngase i njëjti është vlerësuar vetëm për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024, ndërsa për pjesën paraprake edhe pse ka pasur dy mbikëqyrës nuk është vlerësuar, në këtë kuptim të dispozitave të cekura më lartë të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit konstaton se është obligim ligjor që mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për vartësit e tij, mirëpo mbi bazë të provave të lëndës rezulton se nuk është ndërmarr asnjë veprim me qëllim që ankuesi të vlerësohet edhe për pjesën tjetër të vitit e që sipas nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë dhe nenit 10 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, rrjedhimisht përveç që nuk ka veprime të ndërmarra nga mbikëqyrësit, në bazë të provave të lëndës nuk ka asnjë veprim të ndërmarr nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e MINT për të siguruar se vlerësimi është përfunduar edhe pse provat e tilla janë kërkuar sipas kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 28.03.2025, mirëpo sipas përgjigjes në ankesë të datës 03.04.2025 të njëjtat nuk janë siguruar.

Andaj Kolegji i Këshillit, vlerëson se bazuar në dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi, ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e caktuar sipas Vendimit me Nr.Ref.01/27 të datës 03.05.2024, është e detyruar që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën nga data 03.05.2024 deri më datë 04.11.2024, si dhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i caktuar sipas Vendimit me Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023 është i detyruar të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin nga data 01.01.2024 deri më datë 03.05.2024.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.449/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.A;
- Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.